

# Analizë e rezultateve të zgjedhjeve lokale dhe nacionale 2025 nga perspektiva gjinore

Prishtinë, prill 2026



# Analizë e rezultateve të zgjedhjeve lokale dhe nacionale 2025 nga perspektiva gjinore

Prishtinë, prill 2026

**Autor:** Demokraci për Zhvillim (D4D)

Faqosja dhe dizajni: Bubagraphics

E drejta e autorit © 2026. **Democracy for Development (D4D)**. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. [www.d4d-ks.org](http://www.d4d-ks.org)

Qëndrimet e shprehura në këtë publikim janë të D4D-së dhe nuk pasqyrojnë patjetër pikëpamjet e donatorit.

Ky raport është hartuar në kuadër të projektit "Ajo Udhëheq: Luftimi i Gjuhës së Urrejtjes dhe Promovimi i Grave në Udhëheqjen Lokale", mbështetur nga Ambasada e Mbretërisë së Holandës në Kosovë.

# Tabela e përmbajtjes

Hyrje.....	7
<b>Përfshirja e grave në zgjedhjet lokale 2025.....</b>	<b>9</b>
<b>Zgjedhjet për kryetarë të komunave.....</b>	<b>9</b>
<i>Përfaqësimi gjinor i kandidatëve për kryetarë të komunave ...</i>	<i>9</i>
<i>Nominimet e kandidatëve për kryetar të komunave sipas subjekteve politike.....</i>	<i>10</i>
<i>Mbështetja elektorale për kandidatët për kryetar të komunave sipas gjinisë .....</i>	<i>11</i>
<i>Rezultatet e kryetarëve të zgjedhur të komunave sipas gjinisë .....</i>	<i>13</i>
<b>Zgjedhjet për kuvendet komunale .....</b>	<b>14</b>
<i>Përfaqësimi gjinor në listat e kandidatëve për anëtarë të kuvendeve komunale .....</i>	<i>14</i>
<i>Nominimet e kandidatëve për kuvendet komunale sipas subjekteve politike.....</i>	<i>18</i>
<i>Gratë si bartëse të listës .....</i>	<i>21</i>
<i>Mbështetja elektorale e kandidatëve për kuvendet komunale sipas gjinisë.....</i>	<i>22</i>
<i>Anëtarët e zgjedhur në kuvendet komunale sipas subjekteve politike .....</i>	<i>30</i>
<i>Kuota Gjinore .....</i>	<i>31</i>
<b>Përfundime .....</b>	<b>35</b>
<b>Përfshirja e grave në Zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Kosovës.....</b>	<b>37</b>
<b>Analiza për zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës.....</b>	<b>37</b>
<i>Përfaqësimi gjinor në listat e kandidatëve për deputetë .....</i>	<i>37</i>
<i>Nominimet e kandidatëve për deputetë sipas subjekteve politike .....</i>	<i>38</i>
<i>Mbështetja elektorale për kandidatët për deputetë sipas gjinisë .....</i>	<i>40</i>
<i>Rezultatet e deputetëve të zgjedhur .....</i>	<i>45</i>
<i>Kuota Gjinore .....</i>	<i>47</i>
<b>Përfundime .....</b>	<b>49</b>

# Hyrje

Ky raport paraqet një analizë të detajuar të përfshirjes dhe përfaqësimit të grave në zgjedhjet lokale 2025, dhe zgjedhjeve të parakohshme për Kuvend të Kosovës të mbajtur me 28 dhjetor të vitit 2025, duke shqyrtuar në mënyrë sistematike të gjitha fazat e procesit zgjedhor - nga nominimi i kandidatëve/eve, te mbështetja elektorale dhe deri te rezultatet përfundimtare të përfaqësimit. Qëllimi i raportit është të identifikojë shkallën e pjesëmarrjes së grave në politikë, të vlerësojë barrierat strukturore dhe institucionale që ndikojnë në këtë pjesëmarrje, si dhe të ofrojë një kuptim më të thelluar të dinamikave gjinore në konkurrencën elektorale.

Zgjedhjet e vitit 2025 përbëjnë një moment të rëndësishëm për analizë, pasi ato përfshijnë si zgjedhjet lokale, ashtu edhe ato parlamentare të mbajtura në një kontekst politik të ndërlikuar dhe me një intensitet të lartë elektorale. Ky kontekst ofron një bazë të vlefshme për të krahasuar modelet e përfaqësimit gjinor në nivele të ndryshme të qeverisjes dhe për të identifikuar dallimet ndërmjet tyre.

Raporti fokusohet në disa dimensione kryesore të përfaqësimit gjinor: (1) përfaqësimin e grave në listat e kandidatëve, (2) rolin e subjekteve politike në nominimin dhe promovimin e grave, (3) mbështetjen elektorale që gratë arrijnë të sigurojnë në krahasim me burrat, dhe (4) përkthimin e kësaj mbështetjeje në mandate dhe pozita vendimmarrëse. Një vëmendje e veçantë i kushtohet edhe rolit të kuotës gjinore si mekanizëm institucional për balancimin e përfaqësimit, si dhe kufizimeve të saj në arritjen e barazisë substanciale.

Qasja analitike e raportit mbështetet në të dhëna kuantitative nga rezultatet zgjedhore dhe listat e kandidatëve, të cilat janë interpretuar përmes një perspektive gjinore, duke synuar të identifikojë jo vetëm nivelin e përfaqësimit, por edhe faktorët që e përcaktojnë atë. Në këtë kuptim, raporti nuk kufizohet vetëm në përshkrimin e të dhënave, por synon të nxjerrë në pah modelet

strukture dhe praktikave politike që ndikojnë në përfshirjen e grave në politikë.

Gjetjet e raportit kontribuojnë në debatin mbi barazinë gjinore në Kosovë, duke ofruar evidencë empirike për politikëbërësit, partitë politike dhe organizatat e shoqërisë civile, me qëllim të avancimit të pjesëmarrjes së grave në proceset demokratike dhe forcimit të përfaqësimit të tyre në institucionet vendimmarrëse.


# Përfshirja e grave në zgjedhjet lokale 2025

## Zgjedhjet për kryetarë të komunave

### *Përfaqësimi gjinor i kandidatëve për kryetarë të komunave*

Përfshirja e grave në garën për kryetar të komunave në zgjedhjet lokale në Kosovë mbetet dukshëm e kufizuar, si në aspektin e kandidimit ashtu edhe në atë të mbështetjes elektorale. Nga gjithsej 205 kandidatë për kryetar komune në 38 komuna, vetëm 20 ishin gra, që përbën 10% të totalit, ndërsa 185 kandidatë, apo 90%, ishin burra. Ky disproporcion i theksuar tregon për një hendek të vazhdueshëm gjinor në qasjen në garat për pozita ekzekutive në nivel lokal.

*Grafiku 1. Numri i kandidatëve për kryetar të komunave sipas gjinisë*




Shtirja territoriale e kandidateve gra ishte po ashtu e kufizuar. Gratë kandiduan në vetëm 15 komuna, ndërsa në 23 komuna të tjera nuk kishte asnjë grua në garë për kryetare. Edhe në komunat ku ato ishin të pranishme, numri i kandidateve mbeti i ulët: vetëm në Zubin Potok kishte tre kandidate gra, ndërsa në Mitrovicë të Veriut, Prishtinë dhe Prizren garuan nga dy gra. Në të gjitha komunat e

tjera, në garë ishte vetëm nga një kandidate, çka sugjeron një përfaqësim më shumë simbolik sesa konkurrues.

### **Nominimet e kandidatëve për kryetar të komunave sipas subjekteve politike**

*Grafiku 2. Nominimet e kandidateve gra për kryetare të komunave sipas subjekteve politike*



Analiza e nominimeve të grave për kryetare të komunave sipas subjekteve politike tregon një nivel të ulët dhe të fragmentuar të përfaqësimit gjinor në këtë kategori garuese. Në total, vetëm një numër i kufizuar grash janë nominuar nga partitë politike dhe kandidatët e pavarur, duke reflektuar një mungesë të theksuar të priorizimit të grave në garat për pozitat ekzekutive lokale.

Subjektet me numrin më të madh të kandidateve gra janë AAK dhe PDK, me nga 3 nominime secila, të ndjekura nga PSD, ZSPO, NISMA dhe kandidatët e pavarur me nga 2 kandidate. Ndërkohë, LVV, LDK dhe Lista Serbe (SL) kanë nominuar vetëm nga një grua, ndërsa disa subjekte të tjera më të vogla (UJEDINJENJE, SD, NDS) gjithashtu kanë përfaqësim minimal me nga një kandidate secila.


Ky shpërndarje tregon se, edhe pse ekziston një përpjekje minimale për përfshirjen e grave në garën për kryetare komunash, ajo mbetet e kufizuar dhe pa dallime të mëdha ndërmjet subjekteve politike. Asnjë parti nuk shfaq një angazhim të qartë apo dominues në promovimin e grave në këto pozita, ndërsa prania e kandidatëve të pavarur me një numër të barabartë me disa parti politike është tregues i asaj se hapësirat për kandidim nuk janë domosdoshmërisht të lidhura vetëm me strukturat partiake.

Në përgjithësi, të dhënat shfaqin se përfaqësimi i grave në garat për kryetar/e të komunave mbetet simbolik dhe jo proporcional me synimet për barazi gjinore, duke reflektuar barriera të vazhdueshme strukturore dhe politike në avancimin e grave në pozita vendimmarrëse në nivel lokal. Për më tepër, vërehet se gratë shpesh janë nominuar nga partitë politike në komuna më të vogla ose në zona ku këto subjekte nuk kanë bastione të forta elektorale, çka është indikator i një qasje strategjike ku kandidaturat e grave vendosen në gara me probabilitet më të ulët fitoreje, në vend se në komunat kryesore ku konkurrenca dhe rëndësia politike janë më të larta.

### ***Mbështetja elektorale për kandidatët për kryetar të komunave sipas gjinisë***

Disbalanca gjinore bëhet edhe më e theksuar kur analizohen rezultatet elektorale. Kandidatët burra morën gjithsej 820,702 vota apo 98%, ndërsa gratë vetëm 16,316 vota, që përbën rreth 2% të totalit të votave. Ky rezultat tregon se, përveç përfaqësimit të ulët në kandidim, gratë përballen edhe me mungesë të theksuar të mbështetjes elektorale, që mund të lidhet si me pozicionimin e tyre në gara më pak konkurruese, ashtu edhe me mungesën e mbështetjes së mjaftueshme nga partitë politike dhe elektorati.


Grafiku 3. Përqindja e votave të grave kandidatë për kryetare të komunave



Analiza e përqindjes së votave për gratë kandidatë tregon një shpërndarje të pabarabartë të performancës së tyre. Rasti më i dalluar është Komuna e Ranillugut, ku kandidatja grua fitoi 71% të votave dhe u zgjodh kryetare që në raundin e parë, duke përbërë rastin e vetëm të suksesit të plotë elektoral të grave në këto zgjedhje. Në disa komuna të tjera, Deçan (12%) dhe Zubin Potok (6%), gratë arritën rezultate relativisht më konkurruese, duke treguar potencial për përfaqësim më të fuqishëm. Megjithatë, në shumicën e komunave, përqindja e votave për gratë mbeti shumë e ulët, shpesh nën 5%, dhe në disa raste edhe nën 2%, si në Zveçan (1%), Fushë Kosovë (1%) dhe Kaçanik (1%).

### Rezultatet e kryetarëve të zgjedhur të komunave sipas gjinisë

Grafiku 3. Numri i kryetarëve të zgjedhur të komunave 2025 sipas gjinisë



Rezultatet zgjedhore konfirmojnë këtë prirje të pabarazisë gjinore. Vetëm një grua arriti të zgjidhet kryetare komune, ndërsa në raundin e dytë të zgjedhjeve nuk kishte asnjë kandidatë grua, duke e bërë garën përfundimtare ekskluzivisht të dominuar nga burrat.


Në tërësi, këto të dhëna tregojnë për ekzistencën e barrierave të shumta strukturore dhe politike që kufizojnë përfshirjen dhe suksesin e grave në garat për pozita ekzekutive në nivel lokal. Dominimi i burrave në procesin e kandidimit sugjeron mungesë të promovimit të grave nga partitë politike, ndërsa performanca e ulët elektorale në shumicën e rasteve tregon për mungesë të mbështetjes reale dhe vendosje të grave në gara me gjasa të ulëta për fitore. Rasti i Ranillugut, në anën tjetër, dëshmon se kur ekziston mbështetje e mjaftueshme politike dhe elektorale, gratë mund të jenë jo vetëm konkurrese, por edhe dominuese në rezultat.

## Zgjedhjet për kuvendet komunale

### ***Përfaqësimi gjinor në listat e kandidatëve për anëtarë të kuvendeve komunale***

Në zgjedhjet lokale 2025, për 942 ulëse në kuvendet komunale garuan gjithsej 5,302 kandidatë, prej të cilëve 1,964 gra (37%) dhe 3,338 burra (63%). Kjo përbërje konfirmon një dominim të qartë të burrave në ofertën politike, pavarësisht ekzistencës së kuotës gjinore, e cila duket se zbatohet më shumë si minimum formal sesa si standard përfaqësimi.


**Grafiku 4. Përqindje e kandidatëve për anëtarë të kuvendeve komunale sipas gjinisë**



Analiza sipas komunave tregon se përfaqësimi i grave është relativisht më i balancuar në një numër të kufizuar komunash, kryesisht me madhësi më të vogël ose me specifika demografike. Ranillugu (46%), Parteshi (44%) dhe Graçanicë (43%) paraqesin nivelet më të larta të përfaqësimit të grave në lista. Në përgjithësi, komunat me shumicë serbe ose me numër më të vogël ulësesh (si Graçanica, Shtërpca, Mitrovica e Veriut) kanë përqindje më të afërta me barazinë gjinore.


## Analizë e rezultateve të zgjedhjeve lokale dhe nacionale 2025 nga perspektiva gjinore

Grafiku 6. Përqindje e kandidatëve për kuvendet komunale sipas gjinisë



Në anën tjetër, komunat më të mëdha dhe me peshë më të madhe politike karakterizohen nga një përfaqësim dukshëm më i ulët i grave. Në qytetet kryesore si Prizreni, Gjilani, Mitrovica e Jugut dhe Vitia, gratë përbëjnë vetëm rreth 35% të kandidatëve, ndërsa në disa komuna si Podujeva, Lipjani dhe Rahoveci kjo përqindje bie në 33.

Grafiku 5. Numri i grave kandidatë për anëtare të kuvendeve komunale sipas komunave



Në aspektin numerik, komunat me numrin më të madh të kandidatëve evidentojnë gjithashtu një disproporcion të theksuar gjinor. Prishtina, si komuna me më së shumti ulëse (51), ka 275 kandidatë burra dhe 190 gra. Ngjashëm, në Prizren (245 burra, 133 gra) dhe Gjakovë (202 burra, 112 gra), raporti mbetet dukshëm në favor të burrave. Edhe pse numri absolut i grave është më i lartë në këto komuna, hendeuku gjinor mbetet i konsiderueshëm.


Një tjetër indikator i rëndësishëm është raporti kandidat për ulëse, i cili tregon intensitetin e konkurrencës. Në komunat e mëdha, ky raport është dukshëm më i lartë (p.sh. Prishtina me mbi 9 kandidatë për ulëse), por kjo konkurrencë nuk përkthehet në përfaqësim më të mirë gjinor. Përkundrazi, rritja e konkurrencës shoqërohet me një dominim më të madh të burrave në lista.

Në tërësi, të dhënat tregojnë se përfaqësimi i grave në listat për kuvende komunale mbetet i kufizuar dhe i pabarabartë ndërmjet komunave. Gratë janë më të përfaqësuara në komuna më të vogla ose më pak konkurruese politikisht, ndërsa në qendrat kryesore urbane dhe politike vazhdon të dominojë prania e burrave. Kjo sugjeron se kuota gjinore nuk është shndërruar ende në një mekanizëm efektiv për balancim real të përfaqësimit, por më shumë në një obligim formal që nuk sfidon strukturat ekzistuese të fuqisë brenda partive politike.

### ***Nominimet e kandidatëve për kuvendet komunale sipas subjekteve politike***

Analiza e përbërjes gjinore sipas subjekteve politike tregon se dallimet ndërmjet partive janë relativisht të vogla, por mbeten domethënëse në kontekstin e përfaqësimit gjinor. Subjektet politike nominuan gjithsej 1,984 gra kandidatë për kuvendet komunale, që përbën 37% të totalit. Numrin më të madh të grave kandidatë e kishte LVV me 341, pasuar nga PDK me 326 dhe LDK me 302.

Grafiku 6. Nominimet e subjekteve politike për anëtarë të kuvendeve komunale sipas gjinisë



Ndër subjektet kryesore, LVV (38%), PDK (37%) dhe LDK (36%) kanë nivele të ngjashme të përfshirjes së grave në lista, duke qëndruar pak mbi ose rreth mesatares në nivel vendi (37%). AAK paraqet nivelin më të ulët në krahasim me partitë kryesore me 35% gra, ndërsa Lista Serbe (SL) ka përqindjen më të lartë të grave kandidate me 41%, duke qenë i vetmi subjekt që i afrohet më shumë barazisë gjinore në përbërjen e listave.


Megjithatë, fakti që asnjë nga subjektet kryesore politike nuk arrin apo tejkalon në mënyrë të qëndrueshme pragun e barazisë gjinore (50%) tregon se përfshirja e grave mbetet kryesisht e diktuar nga kuota minimale ligjore, dhe jo nga një angazhim i mirëfilltë për barazi gjinore në përfaqësim.

Ngjashmëria e përqindjeve ndërmjet partive sugjeron gjithashtu një model të standardizuar të përzgjedhjes së kandidatëve, ku hapësira për gratë është e kufizuar në mënyrë të njëtrajtshme në të gjithë spektrin politik. Kjo nënkupton se sfida për rritjen e përfaqësimit gjinor nuk është e izoluar në një subjekt të vetëm, por është strukturore dhe përfshin të gjithë sistemin partiak.

Në këtë kontekst, rritja e përfaqësimit të grave kërkon jo vetëm respektimin e kuotave, por edhe ndryshime në praktikën e brendshme të partive, veçanërisht në mënyrën e rekrutimit, promovimit dhe pozicionimit të grave në lista zgjedhore.

### Gratë si bartëse të listës

Grafiku 7. Numri i grave si bartëse të listave të kandidatëve për kuvendet komunale sipas komunave



Për shkak të sistemit zgjedhor për zgjedhjet lokale, ku kandidati i parë në listë që është bartës i listës nuk i nënshtrohet votave preferenciale, por merr votat që shkojnë për subjektin politik në listën e kandidatëve për kuvend komunal, këta kandidatë janë edhe më të privilegjuar. Në 10 komuna nuk kishte asnjë grua bartëse të listës në asnjërin prej subjekteve politike të certifikuara. Në 29 komuna të tjera gratë ish bartëse të listës 57 herë, ku prinë Komuna e Prizrenit me 5 gra bartëse të listës, pastaj Deçani, Prishtina dhe Zubin Potoku me nga 4 gra bartëse të listës.

### **Mbështetja elektorale e kandidatëve për kuvendet komunale sipas gjinisë**

Të dhënat e agreguara për votat konfirmojnë se pabarazia gjinore thellohet më tej në nivelin e mbështetjes elektorale:


- **Burrat** kanë marrë 1,160,760 vota (75%)
- **Gratë** kanë marrë 380,245 vota (25%)

Krahasuar me pjesëmarrjen në lista:

- **Gratë** përbëjnë 37% të kandidatëve, por vetëm 25% të votave
- **Burrat** përbëjnë 63% të kandidatëve, por marrin 75% të votave


Kjo diferencë prej -12 pikë përqindje për gratë tregon një disavantazh të qartë në konvertimin e kandidaturave në mbështetje elektorale.

Grafiku 8. Përqindja e votave të kandidatëve për kuvendet komunale sipas gjinisë



Në nivel komunal, dallimet janë edhe më të theksuara dhe më strukturore. Në një numër të konsiderueshëm komunash, burrat dominojnë qartë votën elektorale, shpesh në nivele mbi 80%, duke reflektuar jo vetëm avantazh numerik në kandidim, por edhe preferencë të theksuar të elektoratit. Komuna si Gjilani (85%), Podujeva (85%), Istogu (87%), Lipjani (86%) dhe Malisheva (86%) përfaqësojnë rastet më ekstreme të këtij dominimi.

Grafiku 9. Përqindja e votave të grave kandidatë për kuvendet komunale



Në komunat e mëdha urbane, ndonëse konkurrenca është më e lartë dhe numri i kandidatëve më i madh, hendeku gjinor mbetet i thellë. Në Prishtinë, gratë marrin vetëm 28% të votave, në Prizren 29%, në Ferizaj 26%, ndërsa në Pejë dhe Mitrovicë të Jugut vetëm 21%. Kjo tregon se madhësia e komunës dhe intensiteti i garës nuk përkthehen në përfaqësim më të drejtë gjinor, përkundrazi, shpesh e thellojnë diferencën.

Në anën tjetër, vetëm në disa komuna të vogla ose me karakteristika specifike lokale vërehet një performancë më e mirë e grave. Ranillugu paraqet rastin më të theksuar, ku gratë marrin 67% të votave, ndërsa në Skenderaj (55%) dhe Novobërdë (51%) ato arrijnë të tejkalojnë ose të balancojnë mbështetjen ndaj burrave. Komuna si Klina (44%) dhe Glllogoci (42%) paraqesin nivele relativisht më të balancuara, por ende me avantazh për burrat.

Ky variacion i theksuar ndërmjet komunave sugjeron se performanca elektorale e grave nuk varet vetëm nga prania e tyre në lista, por ndikohet fuqishëm nga faktorë lokalë strukturorë. Këtu përfshihen niveli i mbështetjes nga partitë politike, pozicionimi i grave në lista, qasja në burime financiare dhe ekspozimi në fushatë, si dhe perceptimet dhe normat sociale të elektoratit.

Në tërësi, të dhënat tregojnë një hendek të dyfishtë gjinor: gratë janë më pak të përfaqësuara në lista dhe, njëkohësisht, kanë më pak gjasa të konvertojnë kandidaturën në votë. Kjo nënkupton se mekanizmat ekzistues, si kuota gjinore, janë të pamjaftueshme për të siguruar përfaqësim real dhe se kërkohen ndërhyrje më substanciale që adresojnë jo vetëm ofertën politike, por edhe kërkesën elektorale dhe strukturat mbështetëse për gratë në politikë.


### ***Rezultatet e anëtarëve të zgjedhur në kuvendet komunale sipas gjinisë***

Të dhënat për kandidatët e zgjedhur japin një pasqyrë më të saktë të suksesit zgjedhor sipas gjinisë. Në total, 604 burra (64%) dhe 338 gra (36%) kanë arritur të fitojnë ulëse në kuvendet komunale. Krahasuar me përbërjen e kandidatëve, ku gratë përbënin 37% dhe

burrat 63%, rezulton një përfaqësim pothuajse proporcional në mandate, me një avantazh minimal për burrat.

Megjithatë, ky proporcionalitet duhet interpretuar në raport me mbështetjen elektorale. Gratë, ndonëse kanë marrë vetëm 25% të votave në total, arrijnë të sigurojnë 36% të ulëseve. Kjo diferencë tregon qartë rolin korrektues të kuotës gjinore dhe mekanizmave të sistemit zgjedhor, të cilët kompensojnë pjesërisht disavantazhin që gratë kanë në votë.

**Grafiku 10. Numri i anëtarëve të zgjedhur në kuvendet komunale sipas gjinisë**



Nga analiza e kombinuar e votave dhe mandateve evidentohet një dinamikë e trefishtë:

- *Disavantazh në vota – Gratë mbeten dukshëm më pak të votuara në raport me burrat në pothuajse të gjitha komunitat.*
- *Kompensim në mandate – Përmes kuotës gjinore, ato arrijnë një nivel përfaqësimi më të lartë sesa do të prodhonte vota e pastër.*
- *Suksesi zgjedhor i kushtëzuar nga sistemi – Rezultati i grave nuk është vetëm produkt i konkurrencës elektorale, por në masë të konsiderueshme i ndërhyrjes institucionale për balancim gjinor.*

Kjo nënkupton se pa mekanizma korrektues, përfaqësimi i grave në kuvendet komunale do të ishte dukshëm më i ulët.

Analiza në nivel komunal tregon dallime të konsiderueshme në përfaqësimin gjinor. Në shumicën e komunave, pjesëmarrja e grave në ulëse sillet në intervalin 30–38%, duke reflektuar drejtpërdrejt pragun minimal të garantuar nga kuota gjinore.

Megjithatë, ka disa devijime të rëndësishme:


- Në disa komuna, përfaqësimi i grave arrin nivele më të larta, 40–43%, si në Prishtinë, Obiliq, Graçanicë dhe Suharekë, duke treguar një kombinim më të favorshëm të votës dhe strukturës së listës.
- Në raste të rralla, si Ranillugu (53%), gratë arrijnë shumicën e ulëseve, duke dëshmuar se në kontekste të caktuara lokale ekziston potencial real për barazi apo edhe dominim.
- Në anën tjetër, komuna si Zveçani (27%) dhe Shtërpca (26%) mbeten dukshëm nën nivelin mesatar, duke reflektuar kufizime më të theksuara në përfaqësim.

Fakti që gratë kanë më pak vota, por arrijnë përfaqësim relativisht proporcional në mandate, tregon se rezultati i tyre ndikohet më shumë nga faktorë strukturorë sesa nga konkurrenca direkte elektorale. Këtu përfshihen:

- pozicionimi në listat zgjedhore,
- aplikimi i kuotës gjinore,
- dhe shpërndarja e votave brenda listave partiake.

Mungesa e grave në pozita të sigurta në lista dhe si bartëse liste vazhdon të jetë një nga pengesat kryesore për një përfaqësim më të drejtë dhe të qëndrueshëm.

Grafiku 11. Përqindja e përfaqësimit të anëtarëve të kuvendeve komunale sipas gjinisë



Të dhënat e përgjithshme tregojnë se përfaqësimi gjinor në kuvendet komunale mbetet i kushtëzuar nga një ndërveprim i dy faktorëve kryesorë: disavantazhi i grave në mbështetjen elektorale dhe roli kompensues i sistemit zgjedhor. Megjithëse gratë përbëjnë 37% të kandidatëve, ato arrijnë të sigurojnë 36% të mandateve, ndërkohë që marrin vetëm 25% të votave. Kjo tregon se përfaqësimi i tyre aktual nuk është rezultat i një mbështetjeje të barabartë nga elektorati, por në masë të konsiderueshme i ndërhyrjeve institucionale, përkatësisht kuotës gjinore dhe mekanizmave korrektues brenda sistemit zgjedhor.

Në këtë kuptim, sistemi zgjedhor arrin të zbusë pabarazinë gjinore në fazën e rezultateve, por nuk e adreson atë në burim. Hendeku ndërmjet votave dhe mandateve dëshmon se gratë vazhdojnë të përballen me barriera strukturore në konkurrencën elektorale, përfshirë qasjen më të kufizuar në resurse, ekspozim më të ulët në fushatë dhe pozicionim më pak të favorshëm në listat zgjedhore. Si rezultat, edhe pse përfaqësimi në mandate duket relativisht proporcional, ai mbetet i brishtë dhe i varur nga rregullat institucionale.


Analiza në nivel komunal e përforcon këtë përfundim. Në shumicën e komunave, përfaqësimi i grave sillet rreth pragut minimal të garantuar nga kuota (30–38%), ndërsa vetëm në raste të izoluara arrihen nivele më të larta që reflektojnë një mbështetje më të gjerë elektorale. Kjo sugjeron se progresi në përfaqësimin e grave nuk është ende i konsoliduar dhe nuk shpërndahet në mënyrë të barabartë në të gjithë territorin.

Në terma të rezultateve të përfaqësimit, mund të konstatohet se sistemi aktual ka prodhuar një rritje relative të pjesëmarrjes së grave në nivel lokal, por jo një barazi substanciale. Përfaqësimi i grave mbetet i ndërmjetësuar nga kuota dhe jo i nxitur nga konkurrenca e lirë dhe e barabartë. Për rrjedhojë, avancimi i mëtejshëm kërkon një qasje më gjithëpërfshirëse, që përfshin jo vetëm ruajtjen e mekanizmave korrektues, por edhe fuqizimin real të grave në procesin politik – përmes rritjes së mbështetjes elektorale, përmirësimit të pozicionimit në lista dhe sigurimit të kushteve të

barabarta në fushatë. Vetëm në këtë mënyrë përfaqësimi gjinor mund të kalojë nga një rezultat i imponuar institucionalisht në një reflektim të vullnetit të lirë të elektoratit.

### **Anëtarët e zgjedhur në kuvendet komunale sipas subjekteve politike**

**Grafiku 12. Anëtarë të zgjedhur të kuvendeve komunale sipas subjekteve politike**



Analiza e përbërjes gjinore të anëtarëve të zgjedhur në kuvendet komunale sipas subjekteve politike tregon se dallimet ndërmjet partive janë të moderuara, por të qëndrueshme në favor të burrave. Në të gjitha subjektet kryesore politike, gratë mbeten nën përfaqësim, duke zënë nga 34% deri në 40% të mandateve.

Lista Serbe (SL) paraqet nivelin më të lartë të përfaqësimit të grave, me 40% të anëtarëve të zgjedhur, duke u afruar më së shumti me një balancë gjinore. Pas saj renditet Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me 38%, ndërsa Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) ka 36% dhe Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) 35%. Partia Demokratike e Kosovës (PDK) ka nivelin më të ulët të përfaqësimit të grave ndër subjektet kryesore, me 34%.


Në aspektin numerik, LDK dhe PDK kanë numrin më të madh të grave të zgjedhura (respektivisht 72 dhe 70), çka lidhet edhe me numrin më të lartë të mandateve që kanë siguruar këto subjekte. Megjithatë, kur analizohen në përqindje, këto parti mbeten nën mesataren e përgjithshme, duke reflektuar një strukturë më të theksuar në favor të burrave.

Në tërësi, të dhënat sugjerojnë se, pavarësisht dallimeve të vogla ndërmjet partive, asnjë subjekt politik nuk arrin një përfaqësim të barabartë gjinor. Nivelet e përfaqësimit të grave janë kryesisht të përqendruara rreth pragut 35–38%, që përkon me efektin e kuotës gjinore, duke treguar se edhe në nivel partiak përfaqësimi i grave mbetet më shumë rezultat i detyrimeve ligjore sesa i një angazhimi të qëndrueshëm për barazi gjinore në strukturat përfaqësuese.

### **Kuota Gjinore**

Analiza e rolit të kuotës gjinore në përzgjedhjen e anëtareve të kuvendeve komunale tregon se ky mekanizëm mbetet vendimtar për nivelin aktual të përfaqësimit të grave. Nga gjithsej 338 gra të zgjedhura, 184 prej tyre kanë siguruar mandat pa ndihmën e kuotës, ndërsa 154 gra, apo 46%, janë zgjedhur falë aplikimit të kuotës gjinore. Kjo do të thotë se pothuajse gjysma e grave të zgjedhura nuk do të ishin pjesë e kuvendeve komunale pa këtë mekanizëm korrektues.

**Grafiku 13. Përfaqësimi i grave në kuvendet komunale me kuotë gjinore**



Në nivel komunal, dallimet janë të theksuara dhe tregojnë varësi të ndryshme nga kuota. Komunat me varësinë më të madhe nga kuota janë Deçani (75%), Gjilani (73%) dhe Gjakova (64%), ku shumica e grave të zgjedhura kanë hyrë në kuvend përmes këtij mekanizmi. Edhe në komuna si Shtërpca (60%) dhe një grup komunash me 50% (përfshirë Mitrovicën e Veriut, Leposaviqin, Zveçanin, Mamushën, Graçanicën dhe Parteshin), kuota ka qenë faktor kyç në sigurimin e përfaqësimit gjinor.

Në anën tjetër, ka komuna ku varësia nga kuota është më e ulët, duke sugjeruar një performancë relativisht më të mirë elektorale të grave. Vitia (33%) dhe Suhareka (36%) paraqesin rastet me përqindjen më të ulët të grave të zgjedhura përmes kuotës, çka nënkupton se një pjesë më e madhe e grave në këto komuna kanë arritur të sigurojnë mandat përmes votës direkte.

Megjithatë, edhe në shumicën e komunave të tjera, përqindja e grave të zgjedhura përmes kuotës sillet ndërmjet 40% dhe 50%, duke treguar një varësi të konsiderueshme nga ky mekanizëm. Kjo shpërndarje konfirmon se, ndonëse ekzistojnë dallime lokale, kuota gjinore mbetet një instrument strukturor i domosdoshëm për të garantuar përfaqësimin e grave.

**Tabela 1. Përfaqësimi i grave në kuvendet komunale sipas kuotës gjinore**

<b>Komuna</b>	<b>Total Gra</b>	<b>Gra pa Kuotë</b>	<b>Gra me Kuotë</b>	<b>% me Kuotë</b>
<b>Deçan</b>	8	2	6	75%
<b>Gjilan</b>	11	3	8	73%
<b>Gjakovë</b>	14	5	9	64%
<b>Shtërpçë</b>	5	2	3	60%
<b>Mitrovicë e Veriut</b>	6	3	3	50%
<b>Leposaviq</b>	6	3	3	50%

**Analizë e rezultateve të zgjedhjeve  
lokale dhe nacionale 2025 nga  
perspektiva gjinore**

<b>Zveçan</b>	4	2	2	50%
<b>Mamushë</b>	6	3	3	50%
<b>Graçanicë</b>	8	4	4	50%
<b>Partesh</b>	6	3	3	50%
<b>Pejë</b>	13	7	6	46%
<b>Prishtinë</b>	22	12	10	46%
<b>Podujevë</b>	11	6	5	46%
<b>Mitrovicë e Jugut</b>	11	6	5	46%
<b>Vushtri</b>	11	6	5	46%
<b>Istog</b>	9	5	4	44%
<b>Fushë Kosovë</b>	9	5	4	44%
<b>Malishevë</b>	9	5	4	44%
<b>Obiliq</b>	9	5	4	44%
<b>Prizren</b>	16	9	7	44%
<b>Ferizaj</b>	14	8	6	43%
<b>Dragash</b>	7	4	3	43%
<b>Klinë</b>	10	6	4	40%
<b>Lipjan</b>	10	6	4	40%
<b>Rahovec</b>	10	6	4	40%
<b>Novobërdë</b>	5	3	2	40%
<b>Zubin Potok</b>	5	3	2	40%
<b>Junik</b>	5	3	2	40%

<b>Hani i Elezit</b>	5	3	2	40%
<b>Kllokot</b>	5	3	2	40%
<b>Glllogoc</b>	8	5	3	38%
<b>Skenderaj</b>	8	5	3	38%
<b>Kaçanik</b>	8	5	3	38%
<b>Kamenicë</b>	8	5	3	38%
<b>Shtime</b>	8	5	3	38%
<b>Ranillug</b>	8	5	3	38%
<b>Suharekë</b>	11	7	4	36%
<b>Viti</b>	9	6	3	33%

Në tërësi, të dhënat tregojnë se përfaqësimi aktual i grave në kuvendet komunale nuk është ende rezultat i një konkurrimi të barabartë në tregun elektoral, por mbështetet në mënyrë të konsiderueshme në ndërhyrjen institucionale. Kjo nënvizon nevojën për masa shtesë që të rrisin aftësinë konkurruese të grave përtej kuotës, përfshirë përmirësimin e pozicionimit në lista, rritjen e mbështetjes nga partitë politike dhe zgjerimin e mbështetjes elektorale.

## Përfundime

Analiza e përgjithshme e përfaqësimit të grave në zgjedhjet lokale 2025 konfirmon ekzistencën e një pabarazie të strukturuar gjinore në të gjitha fazat e procesit zgjedhor - nga kandidimi, te mbështetja elektorale dhe deri te shpërndarja e mandateve.

Së pari, hendeku fillon në ofertën politike. Gratë përbëjnë vetëm 37% të kandidatëve për kuvendet komunale dhe vetëm 11% të kandidatëve për kryetare komunash, duke reflektuar një qasje të kufizuar në proceset e nominimit dhe një mungesë të promovimit aktiv nga partitë politike. Për më tepër, kandidaturat e grave për pozita ekzekutive shpesh janë përqendruar në komuna më të vogla ose në zona ku subjektet politike nuk kanë bastione të forta, çka redukton ndjeshëm gjasat për sukses real elektorale.

Së dyti, pabarazia thellohet në nivelin e mbështetjes elektorale. Gratë kanë marrë vetëm 25% të votave për kuvendet komunale dhe një përqindje shumë të ulët në garat për kryetare komunash. Ky disproporcion tregon se gratë përballen me barriera të shumëfishta në tërheqjen e votës, përfshirë mungesën e burimeve financiare, ekspozimin më të ulët në fushatë, pozicionimin më pak të favorshëm në lista dhe vazhdimësinë e stereotipeve gjinore në elektorat.

Megjithatë, në fazën e rezultateve, sistemi zgjedhor prodhon një efekt të dukshëm korrektues. Gratë përbëjnë 36% të anëtarëve të zgjedhur në kuvendet komunale, një nivel që tejkalon ndjeshëm pjesën e votave që kanë marrë. Kjo tregon se kuota gjinore dhe mekanizmat institucionalë kanë qenë vendimtarë në garantimin e një përfaqësimi minimal dhe në zbutjen e pabarazisë së prodhuar nga vota.

Roli i kuotës gjinore është veçanërisht i theksuar: 46% e grave të zgjedhura kanë siguruar mandat falë këtij mekanizmi. Në shumë komuna, përfaqësimi i grave mbetet i lidhur drejtpërdrejt me aplikimin e kuotës, ndërsa vetëm në disa raste të izoluar vërehet një performancë më e mirë elektorale e pavarur nga ky instrument.

Kjo nënkupton se përfaqësimi aktual i grave është ende i ndërmjetësuar nga rregullat e sistemit dhe jo i bazuar në një konkurrencë të barabartë.

Në të njëjtën kohë, analiza në nivel komunal dhe partiak tregon se nuk ka dallime të theksuara ndërmjet subjekteve politike - shumica e tyre operojnë brenda një "tavani" të ngjashëm për përfaqësimin e grave (rreth 34–40%). Kjo sugjeron se sfida nuk është e izoluar në një parti të vetme, por është sistemike dhe lidhet me mënyrën se si funksionojnë strukturat partiake dhe dinamika elektorale në tërësi.

Në përfundim, zgjedhjet lokale 2025 tregojnë se përfaqësimi i grave në Kosovë ka shënuar një progres të moderuar në aspektin formal, por mbetet i kufizuar në aspektin substancial. Sistemi zgjedhor arrin të zbusë pabarazinë në rezultate, por nuk e eliminon atë në burim. Për të arritur një barazi reale gjinore, është e nevojshme të kalohen kufijtë e kuotës dhe të adresohen faktorët strukturorë që ndikojnë në konkurrencën elektorale, duke përfshirë fuqizimin e grave brenda partive politike, përmirësimin e pozicionimit të tyre në lista dhe rritjen e mbështetjes nga elektorati.


# Përfshirja e grave në Zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Kosovës

## Analiza për zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës

### ***Përfaqësimi gjinor në listat e kandidatëve për deputetë***

Zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Kosovës u mbajtën me 28 dhjetor 2025, në një kontekst të një krize të thellë politike dhe institucionale, e cila pasoi zgjedhjet e rregullta parlamentare të 9 shkurtit 2025. Për afro dhjetë muaj pas këtyre zgjedhjeve, Kosova mbeti pa formimin e një qeverie të re, për shkak të fragmentimit të përbërjes parlamentare dhe pamundësisë së subjekteve politike për të siguruar shumicën e nevojshme për konstituimin e institucioneve.

**Grafiku 14. Numri i kandidatëve për deputetë sipas gjinisë**




Në garën për 120 deputetë, u certifikuan 24 subjekte politike, me gjithsej 1,180 kandidatë për deputetë. Nga të cilët 789 ishin burra

(67%) dhe 391 gra (33%). Asnjë nga subjektet kryesore politike nuk ka kaluar pragun prej ~35% përfaqësim të grave, çka tregon mungesë të vullnetit politik për të shkuar përtej minimumit ligjor. Grupmosha 41-50 vjeç përbën përqindjen më të madhe të listave, e ndjekur nga grupmosha 31-40 vjeç. Përfaqësimi i të rinjve mbetet i kufizuar, ndërsa kandidatët mbi 65 vjeç përbëjnë një pjesë të vogël të listave. Mosha mesatare e kandidatëve në subjektet kryesore politike sillet ndërmjet 42 dhe 46 vjeç, duke konfirmuar dominimin e profileve të konsoliduara politike. 524 kandidatë (44%) kanë kandiduar edhe në zgjedhjet parlamentare të 9 shkurtit 2025, ndërsa 362 kandidatë (31%) kanë qenë pjesë e zgjedhjeve lokale të të njëjtit vit. 149 kandidatë (13%) kanë kandiduar në të dy proceset zgjedhore.<sup>1</sup>

### **Nominimet e kandidatëve për deputetë sipas subjekteve politike**

**Grafiku 15. Nominimet e kandidatëve për deputetë të subjekteve politike sipas gjinisë**



Analiza e nominimeve të kandidatëve për deputetë nga subjektet politike për zgjedhjet nacionale 2025 tregon një strukturë të qëndrueshme gjinore, me dallime minimale ndërmjet partive. Në

<sup>1</sup> Demokracia në Veprim. "Raport i Vëzhgimit të Zgjedhjeve për Kuvendin e Kosovës 2025". I qasshëm në: <https://kdi-kosova.org/wp-content/uploads/2026/03/02-Raporti-i-vezhgimit-te-Zgjedhjeve-per-Kuvendin-e-Kosoves-08.pdf>

total, përfaqësimi i grave në listat zgjedhore sillet ndërmjet 33% dhe 35%, duke reflektuar një nivel pothuajse uniform të përfshirjes në të gjitha subjektet politike.


Lëvizja Vetëvendosje (LVV) ka përqindjen më të lartë të grave në listë, me 35% (39 gra nga 110 kandidatë), duke u pozicionuar lehtësisht mbi partitë tjera. Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dhe Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) paraqesin një strukturë identike gjinore, me nga 34% gra (37 gra nga 110 kandidatë secila). Ndërkohë, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dhe Lista Serbe (SL) kanë përfaqësimin më të ulët të grave, me nga 33%, që përkon me nivelin minimal të kërkuar nga kuota gjinore.

Në të gjitha subjektet politike vihet re dominimi i kandidatëve burra, të cilët përbëjnë nga 65% deri në 67% të listave. Ky raport mbetet konsistent pavarësisht madhësisë së listës apo profilit të subjektit politik, duke treguar se përfaqësimi gjinor nuk ndikohet ndjeshëm nga faktorë të brendshëm partiakë, por ndjek një model të përgjithshëm sistemik.

Në tërësi, të dhënat sugjerojnë se subjektet politike kryesisht e përmbushin kuotën gjinore si detyrim ligjor, pa shfaqur përpjekje të dukshme për ta tejkaluar atë. Mungesa e variacionit ndërmjet partive tregon se nuk ekziston një konkurrencë reale për avancimin e përfaqësimit të grave, duke e lënë përfshirjen gjinore në nivel minimal dhe të standardizuar.

### Mbështetja elektorale për kandidatët për deputetë sipas gjinisë

Grafiku 16. Paraqitja e votave të kandidatëve sipas gjinisë




Analiza e përgjithshme e votave të kandidatëve sipas gjinisë tregon një pabarazi të theksuar në shpërndarjen totale të votave, por një performancë relativisht të balancuar në nivel individual. Burrat kanë marrë 5,220,676 vota, që përbëjnë 71% të totalit, ndërsa gratë kanë siguruar 2,083,555 vota apo 29%. Ky disproporcion lidhet drejtpërdrejt me numrin më të madh të kandidatëve burra në garë (789 krahasuar me 391 gra), çka tregon një ofertë politike të dominuar nga burrat.

Megjithatë, kur analiza fokusohet në mesataren e votave për kandidat, dallimet gjinore ngushtohen dukshëm. Gratë kanë fituar mesatarisht 5,329 vota për kandidate, ndërsa burrat 6,329 vota për kandidat. Ky hendek është relativisht i vogël dhe tregon se performanca elektorale e grave nuk mbetet prapa asaj të burrave. Përkundrazi, të dhënat sugjerojnë se, sa herë që gratë përfshihen në garë, ato arrijnë nivele pothuajse të barabarta të mbështetjes elektorale, duke dëshmuar konkurrueshmëri reale dhe potencial të konsiderueshëm përfaqësimi.

Në këtë kuptim, hendeku gjinor në vota nuk reflekton një mungesë mbështetjeje nga votuesit për gratë, por më tepër një disbalancë në numrin e kandidatëve dhe mundësitë për të hyrë në garë. Kjo sugjeron se sfida kryesore mbetet në fazën e nominimit dhe

strukturave partiake, ndërsa në aspektin e mbështetjes elektorale, gratë dëshmojnë potencial të barabartë për sukses.

**Grafiku 17. Mesatarja e votave të kandidatëve për deputetë sipas subjekteve politike**



Analiza e mesatares së votave për kandidatët për deputetë sipas gjinisë dhe subjekteve politike nxjerr në pah dallime të dukshme ndërmjet partive, por edhe një model të përgjithshëm në favor të kandidatëve burra.

Në të gjitha subjektet politike, kandidatët burra kanë siguruar mesatarisht më shumë vota sesa gratë. Diferenca është më e theksuar në disa parti, duke reflektuar pabarazi në shpërndarjen e mbështetjes elektorale brenda listave.

Në AAK, hendeku është veçanërisht i madh, ku burrat kanë mesatarisht 4,086 vota për kandidat, ndërsa gratë vetëm 2,138 vota. Ky është dallimi më i thellë ndërmjet gjinive në krahasim me subjektet tjera dhe sugjeron një avantazh të qartë për kandidatët burra në këtë parti.

Në LVV, edhe pse të dyja gjinitë arrijnë nivele të larta votash, burrat mbeten përpara me 37,879 vota mesatarisht, krahasuar me 30,904 vota për gratë. Megjithatë, ky është një nga rastet ku gratë shfaqin

konkurrueshmëri më të lartë relative, duke ngushtuar diferencën krahasuar me partitë tjera.


LDK paraqet një hendek më të moderuar, me 8,899 vota mesatarisht për burrat dhe 7,227 për gratë, duke sugjeruar një shpërndarje më të balancuar të votave ndërmjet gjinive.

Në PDK, diferenca është sërish e theksuar, ku burrat kanë mesatarisht 14,934 vota, ndërsa gratë 9,275, duke reflektuar një epërsi të konsiderueshme të kandidatëve burra.

Ndërkaq, në SL, edhe pse diferenca ekziston (8,624 për burrat kundrejt 7,116 për gratë), ajo është relativisht më e vogël, duke treguar një balancë më të afërt në mbështetjen elektorale.

Në tërësi, të dhënat tregojnë se, ndonëse gratë janë të pranishme në lista dhe në disa raste arrijnë nivele të konsiderueshme votash, ato vazhdojnë të marrin më pak mbështetje mesatarisht sesa burrat në të gjitha subjektet politike. Megjithatë, shkalla e këtij hendeku ndryshon ndërmjet partive, duke sugjeruar se faktorët e brendshëm partiakë, si renditja në listë, ekspozimi gjatë fushatës dhe mbështetja organizative, mund të ndikojnë ndjeshëm në performancën elektorale të kandidateve gra.

Grafiku 18. Mbështetja e kandidateve gra për deputete sipas komunave




Analiza e përqindjes së votave për gratë kandidatë në listat për deputete sipas komunave tregon se vetëm 9 komuna (rreth 24%) e tejkalojnë pragun prej 30%, ndërsa 29 komuna (rreth 76%) mbeten në ose nën këtë nivel. Edhe në komunat me performancë më të mirë, përqindja maksimale arrin në 37%, çka mbetet dukshëm larg balancës gjinore. Kjo situatë bëhet edhe më domethënëse kur merret parasysh se vetëm 33% e kandidatëve për deputetë kanë qenë gra, duke reflektuar një nën-përfaqësim që fillon që në fazën e nominimit dhe që më pas përkthehet edhe në mbështetje më të ulët elektorale.

Në anën tjetër, pjesa dërrmuese e komunave karakterizohet nga nivele prej 30% ose më pak, me një përqendrim të madh në intervalin 25–29%, dhe disa raste që bien deri në 19%. Kjo shpërndarje tregon një model të qëndrueshëm të nën-përfaqësimit të grave në mbështetjen elektorale, duke reflektuar kufizime strukturore dhe sociale që vazhdojnë të ndikojnë në votimin për gratë kandidatë, si dhe efektin zinxhir të përfaqësimit të ulët në lista.

Mbështetja për gratë mbetet e kufizuar në shumicën e komunave, me përparim të pjesshëm në një numër të vogël rastesh, por pa arritur ende nivele të kënaqshme të barazisë gjinore në përfaqësim. Në tërësi, kombinimi i përfaqësimit të ulët në lista (33%) dhe i përqindjes së ulët të votave në shumicën e komunave tregon për një hendek të dyfishtë gjinor, si në ofertën politike ashtu edhe në sjelljen elektorale.

### Rezultatet e deputetëve të zgjedhur

Grafiku 19. Përfaqësimi gjinor në Kuvendin e Kosovës




Analiza e përbërjes gjinore të deputetëve të zgjedhur sipas subjekteve politike tregon një dominim të qartë të burrave në përfaqësimin parlamentar. Nga gjithsej 120 deputetë të zgjedhur, 79 janë burra (rreth 66%), ndërsa 41 janë gra (rreth 34%).

Ky rezultat reflekton një përmirësim relativ në përfaqësimin e grave krahasuar me nivelet tradicionale, duke iu afruar pragut të kuotës gjinore prej 30%. Megjithatë, pavarësisht këtij progresi, mbetet një hendek i dukshëm gjinor në përbërjen e Kuvendit, që tregon se gratë vazhdojnë të jenë të nën-përfaqësuar në raport me burrat.

Në këtë kontekst, edhe pse mekanizmat si kuota gjinore kanë ndikuar në rritjen e pranisë së grave në Kuvend, rezultatet sugjerojnë se përfaqësimi substancial dhe i barabartë gjinor ende nuk është arritur, duke nënvizuar nevojën për masa shtesë që adresojnë pengesat strukturore dhe mbështesin avancimin e grave në politikë.

Grafiku 20. Përfaqësimi gjinor në Kuvendin e Kosovës sipas subjekteve politike



Analiza e përbërjes gjinore të deputetëve të zgjedhur sipas subjekteve politike tregon se pabarazia gjinore është e pranishme në pothuajse të gjitha partitë, pavarësisht dallimeve në madhësi dhe fuqi elektorale.

Subjekti më i madh politik, LVV, ka numrin më të lartë të grave të zgjedhura (21), por edhe këtu burrat mbeten dominues (36), duke reflektuar një raport prej rreth 37% gra. Një model i ngjashëm vërehet edhe te PDK (7 gra, 15 burra) dhe LDK (5 gra, 10 burra), ku përfaqësimi i grave sillet rreth një të tretës, duke qenë në linjë me kuotën minimale ligjore, por larg barazisë reale.

Te subjektet më të vogla si SL dhe AAK, raporti gjinor mbetet i njëjtë (rreth 33% gra dhe 67% burra), çka sugjeron një model të qëndrueshëm ndërpartiak, ku gratë arrijnë përfaqësim kryesisht përmes mekanizmave të kuotës, dhe më pak përmes konkurrencës së barabartë elektorale.


Ndërkaq, disa subjekte më të vogla paraqesin raste më të balancuara ose edhe përfaqësim të barabartë gjinor, si KDTP (1

grua dhe 1 burrë), megjithëse këto raste janë numerikisht të kufizuara dhe nuk ndikojnë ndjeshëm në përbërjen e përgjithshme të Kuvendit. Në anën tjetër, disa subjekte kanë vetëm përfaqësim mashkullor (si IRDK, JGP, VAKAT, LPRK, PLE, PSA, ZSPO), ndërsa disa të tjera vetëm një grua (NDS, SDU), duke theksuar mungesën e balancës gjinore në partitë me përfaqësim minimal.

Në tërësi, analiza sipas subjekteve politike konfirmon se përfaqësimi i grave është i përqendruar kryesisht në nivelin e kuotës minimale dhe nuk reflekton ende një integrim të plotë të grave në strukturat konkurruese të politikës. Ky model sugjeron se përtej kuotave, nevojiten politika më aktive brenda partive politike për të promovuar dhe mbështetur gratë në pozita fituese në lista zgjedhore.

### **Kuota Gjinore**

**Grafiku 21. Përfaqësimi i grave në Kuvend të Kosovës sipas kuotës gjinore**




Analiza e përfaqësimit të grave në Kuvendin e Kosovës, në raport me kuotën gjinore prej 30% për gjininë më pak të përfaqësuar, tregon një zhvillim relativisht pozitiv, por ende të papërfunduar drejt barazisë substanciale.

Nga gjithsej 41 gra deputete të zgjedhura, vetëm 7 prej tyre (rreth 17%) kanë hyrë në Kuvend përmes mekanizmit korrektues të kuotës gjinore, ndërsa shumica dërrmuese - 34 gra (rreth 83%) - janë zgjedhur drejtpërdrejt mbi bazën e votës së fituar. Ky është një

tregues i rëndësishëm se kuota gjinore, edhe pse mbetet një instrument i nevojshëm, nuk është më faktori dominues në sigurimin e përfaqësimit të grave. Përkundrazi, një pjesë e konsiderueshme e grave po arrijnë të konkurrojnë dhe të fitojnë në mënyrë të barabartë në tregun elektoral.

Megjithatë, fakti që 7 gra ende kanë pasur nevojë për ndërhyrjen e kuotës tregon se barrierat strukturore dhe elektorale vazhdojnë të ekzistojnë. Kuota mbetet një mekanizëm sigurie për të parandaluar nën-përfaqësimin dhe për të garantuar një nivel minimal përfshirjeje.

**Grafiku 22. Përfaqësimi i grave në Kuvend të Kosovës me kuota gjinore sipas subjekteve politike**



Shpërndarja e mandateve të fituara përmes kuotës sipas subjekteve politike (PDK me 3, AAK me 2, Lista Serbe me 1 dhe KDTP me 1) tregon se nevoja për kuota nuk është uniforme ndërmjet partive. Disa subjekte politike vazhdojnë të kenë më pak kapacitet ose vullnet për të siguruar zgjedhjen e grave përmes votës direkte, duke u mbështetur më shumë në mekanizmin korrektues.

Në tërësi, kuota gjinore ka luajtur një rol të rëndësishëm historik në rritjen e përfaqësimit të grave, por të dhënat aktuale tregojnë një tranzicion gradual drejt një modeli ku gratë po sigurojnë mandate gjithnjë e më shumë përmes konkurrencës së lirë. Megjithatë, përderisa një pjesë e grave ende varet nga kuota, ajo mbetet një instrument i domosdoshëm për të garantuar përfaqësim të drejtë dhe për të adresuar pabarazitë strukturore në sistemin politik.

## Përfundime

Analiza e të dhënave për zgjedhjet parlamentare të dhjetorit 2025 konfirmon se përfaqësimi gjinor në Kosovë vazhdon të karakterizohet nga një hendek i strukturuar ndërmjet burrave dhe grave, i cili manifestohet në të gjitha fazat e procesit zgjedhor – nga nominimi, te mbështetja elektorale, deri te rezultatet përfundimtare.

Së pari, përbërja e listave zgjedhore tregon qartë se përfshirja e grave mbetet e kufizuar në nivelin minimal ligjor. Me vetëm 33% gra në listat e kandidatëve dhe pa asnjë subjekt që e tejkalon ndjeshëm këtë prag, bëhet e qartë se partitë politike nuk e trajtojnë barazinë gjinore si prioritet politik, por kryesisht si detyrim formal. Uniformiteti ndërmjet partive në këtë aspekt tregon mungesë të konkurrencës reale për avancimin e grave në politikë.

Së dyti, analiza e votave tregon se problemi kryesor nuk qëndron në mungesën e mbështetjes nga votuesit. Edhe pse burrat dominojnë në numrin total të votave, për shkak të numrit më të madh të kandidatëve, mesatarja e votave për kandidat dëshmon një diferencë relativisht të vogël ndërmjet gjinive. Kjo nënkupton se gratë janë konkurrese në terma elektorale dhe se potenciali i tyre për sukses është i krahasueshëm me atë të burrave. Për rrjedhojë, pengesa kryesore mbetet qasja në garë dhe pozicionimi brenda listave, më shumë sesa preferencat e elektoratit.

Së treti, shpërndarja territoriale e votave për gratë konfirmon një model të qëndrueshëm të nën-përfaqësimit. Me vetëm një pjesë të vogël të komunave që arrijnë mbi 30% mbështetje për gratë dhe shumicën që mbetet nën këtë nivel, evidentohet një kombinim i faktorëve strukturorë dhe socio-kulturorë që ndikojnë negativisht në votimin për gratë. Ky fenomen përforcon atë që mund të konsiderohet si "hendek i dyfishtë gjinor" - njëkohësisht në ofertën politike dhe në mbështetjen elektorale.

Së fundi, rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve tregojnë se përfaqësimi i grave në Kuvend (34%) mbetet i lidhur ngushtë me mekanizmin e kuotës gjinore. Edhe pse ka një përmirësim krahasuar

me periudhat e mëhershme, struktura parlamentare vazhdon të dominohet nga burrat. Analiza sipas subjekteve politike konfirmon se gratë arrijnë përfaqësim kryesisht në nivelin minimal të kërkuar, ndërsa mungon një integrim i plotë dhe konkurrues në pozita fituese.

Në tërësi, gjetjet e kësaj pjese tregojnë se sfida kryesore për avancimin e barazisë gjinore në politikë nuk është vetëm rritja numerike e përfaqësimit, por transformimi i mënyrës se si partitë politike rekrutojnë, rendisin dhe mbështesin gratë candidate. Pa ndërhyrje më të thella në këto mekanizma, përfaqësimi i grave do të vazhdojë të mbetet i kufizuar dhe i varur nga kuotat, duke mos arritur të reflektojë plotësisht potencialin dhe mbështetjen që ato gëzojnë në elektorat.

## Lista e publikimeve

Democracy for Development (D4D). (2022). *Fushata zgjedhore në llupë*. <https://d4d-ks.org/punimet/fushata-zgjedhore-ne-llupe>

Democracy for Development (D4D). (2022). *Portalet dhe mediat sociale në llupë*. [https://d4d-ks.org/wp-content/uploads/2022/03/D4D\\_Q1report\\_SHQ\\_Final.pdf](https://d4d-ks.org/wp-content/uploads/2022/03/D4D_Q1report_SHQ_Final.pdf)

Democracy for Development (D4D). (2022). *Ofrimi i shërbimeve digjitale në nivel lokal në Kosovë: Komuna e Podujevës, Lipjanit dhe Drenasit*. [https://d4d-ks.org/wp-content/uploads/2022/04/D4D\\_Digi-Komunat\\_SHQ\\_web-1.pdf](https://d4d-ks.org/wp-content/uploads/2022/04/D4D_Digi-Komunat_SHQ_web-1.pdf)

Democracy for Development (D4D). (2022). *Rini aktive për zhvillim të qëndrueshëm*. [https://d4d-ks.org/wp-content/uploads/2022/05/D4D\\_PolicyBrief\\_Rinia\\_04\\_SHQ\\_web.pdf](https://d4d-ks.org/wp-content/uploads/2022/05/D4D_PolicyBrief_Rinia_04_SHQ_web.pdf)

Democracy for Development (D4D). (2022). *Raportimi i lajmeve nga portalet online – rrjetet sociale dhe ndikimi tek publiku*. [https://d4d-ks.org/wp-content/uploads/2022/06/D4D\\_Q2report\\_SHQ\\_03\\_WEB.pdf](https://d4d-ks.org/wp-content/uploads/2022/06/D4D_Q2report_SHQ_03_WEB.pdf)

Democracy for Development (D4D). (2022). *Ide për diskutim: Sugjerime për Strategjinë e ardhshme të Punësimit*. [https://d4d-ks.org/wp-content/uploads/2022/07/D4D\\_Analize\\_Food4Thought\\_03\\_SHQ\\_WEB.pdf](https://d4d-ks.org/wp-content/uploads/2022/07/D4D_Analize_Food4Thought_03_SHQ_WEB.pdf)

Democracy for Development (D4D). (2022). *Informacioni i çrregullt: Ndikimi i tij tek informimi i qytetarëve*. [https://d4d-ks.org/wp-content/uploads/2022/09/D4D\\_Q3report\\_Final\\_SHQ\\_WEB.pdf](https://d4d-ks.org/wp-content/uploads/2022/09/D4D_Q3report_Final_SHQ_WEB.pdf)

Democracy for Development (D4D). (2022). *Dhuna online ndaj grave në politikë*. <https://d4d-ks.org/wp-content/uploads/2022/10/Dhuna-online-ndaj-grave-ne-politike.pdf>

Democracy for Development (D4D). (2022). *Raporti monitorues i lajmeve me çrregullim të informacionit – Çfarë ndikimi patën portalet dhe rrjetet sociale nga muaji korrik deri në shtator*. <https://d4d-ks.org/wp-content/uploads/2022/10/Raporti-Q4.pdf>

Democracy for Development (D4D). (2024). *Përfaqësimi gjinor në trupat për menaxhimin e zgjedhjeve*. [https://d4d-ks.org/wp-content/uploads/2024/11/D4D\\_Raporti\\_KQZ\\_05-SHQ\\_v2-1.pdf](https://d4d-ks.org/wp-content/uploads/2024/11/D4D_Raporti_KQZ_05-SHQ_v2-1.pdf)

**Katalogimi në botim (CIP)**

**Biblioteka Kombëtare e Kosovës - Pjetër Bogdani**

---

Instituti "Demokrasi për zhvillim" (D4D) është themeluar në prill të vitit 2010 nga një grup analistësh të cilët ishin gjithnjë e më të shqetësuar se procesi i shtet-ndërtimit e kishte anashkaluar demokracinë. Vizioni i D4D është promovimi i një qytetarie aktive dhe të informuar, që merr pjesë plotësisht në hapësirën publike dhe që përdor arenën publike të përfaqësimit dhe vendimmarrjes për të diskutuar dhe ndërtuar konsensus mbi ndarjen e burimeve në mënyrë efikase, të zgjuar dhe afatgjatë, duke kontribuar në zhvillim të barabartë. D4D ndikon në politika konkrete, promovon një qasje ndërsektoriale Wndaj zgjidhjes së problemeve dhe trajton rutinën institucionale të vendimmarrjes duke rekomanduar përmirësime graduale dhe duke vepruar me efektivitet maksimal për të kontribuar në stabilizimin dhe zhvillimin demokratik të Kosovës.



Për më shumë informacion rreth aktiviteteve të D4D, ju lutemi vizitoni uebsajtin tonë: **[www.d4d-ks.org](http://www.d4d-ks.org)**